



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office



Nr.82/2022

Datë: 14.06.2022

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit z. Hajrulla Çeku, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019) bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) nenin 14 (paragrafi 1 nen paragrafi 1,8) shtojca 1 e Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30 Mars 2021), nenit 31 dhe 32 të Ligjit për Sport Nr. 2003/24, nenin 22,23, 24 dhe 26 të Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Themelimit, Licencimit dhe Ri-Vlerësimit të Federatave dhe Organizatave Sportive, mori këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni vlerësues për licencim të Federatave sportive.
2. Komisioni vlerësues për licencim të Federatave sportive, ka këtë përbërje:
 - 2.1. Fidan Shatri - Kryesues;
 - 2.2. Egzontina Thaçi - anëtare;
 - 2.3. Fatmir Kabashi - anëtar;
 - 2.4. Jehona Bashota - anëtare;
 - 2.5. Blerina Imeri - anëtare.
3. Komisioni emërohet me mandat katër (4) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një tjetër.
4. Komisioni si në paragrafin 2 të këtij vendimi është organ kompetent i autorizuar për shqyrtimin e kërkesave të federatave sportive për dhënie, refuzimin apo revokimit e licencave, siç është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Themelimit, Licencimit dhe Ri-Vlerësimit të Federatave dhe Organizatave Sportive.
5. Anëtarët e Komisioni vlerësues për licencim të Federatave sportive si në paragrafin 2 të këtij vendimi, bazuar në Udhëzim Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Themelimit, Licencimit dhe Ri-Vlerësimit të Federatave dhe Organizatave Sportive, kompensohen financiarisht për punën e tyre. Kompensimi lejohet në vlerë prej 125.00€ (njëqind e njëzetë e pesë euro) për Kryesuesin, ndërsa 100€ (njëqind euro) për anëtarët e Komisionit, por jo më shumti për 2 (dy) mbledhje brenda muajit.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Anëtareve të Emëruar;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Departamentit të Sportit;*
- *Arkivit të MKRS-së.*

